



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

P- 059/2

Prishtinë, më 29, 30 janar dhe 2 shkurt 2009

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 29, 30 JANAR DHE 2 SHKURT 2009

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 90 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ai propozoi që pika e dhjetë të riradhitet në pikën e tretë të rendit të ditës. Kuvendi miratoi propozimin e kryetarit.

Në fillim të seancës, për fjalë u lajmëruan këta deputetë:

Deputeti **Driton Tali** shpjegoi përkufizimin e nocionit “racizëm” dhe kërkoi që ai të përfshihet në tekstin e Rezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë.

Kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian, **Zylfja Hundozi**, propozoi që pika e gjashtë të hiqet nga rendi i ditës, me arsyetimin se Komisioni, pas shqyrtimit, ka arritur në përfundim se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit nuk është në përputhshmëri me parimet bazë të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Kryetarja e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri..., **Myzejene Selmani**, tha se Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë atë.

Deputeti **Nait Hasani** paraqiti shqetësimin lidhur me fyerjet dhe kërcënimet që i ishin bërë nga kandidati për Këshillin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, Nazmi Mustafi, emërimin e të cilin ai e kishte kundërshtuar në seancën e mëparshme.

Ai tha se në sistemin gjyqësor e prokurorial të Kosovës ka gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët në të kaluarën i kanë shërbyer regjimit të Serbisë në Kosovë. Ai kërkoi nga Presidenti i Kosovës që ata t’i shkarkojë nga detyra.

Deputeti **Gani Geci** tha se solidarizohet me qëndrimin e deputetit Hasani dhe kërkoi që në seancën e radhës Kuvendi ta miratojë Rezolutën kundër krimeve të komunizmit në Kosovë.

Deputeti **Adem Salihaj** mbështeti qëndrimin e deputetit Hasani dhe kërkoi sqarime për mos radhitjen e Projekt-Rezolutës kundër krimeve të komunizmit në rend dite të kësaj seance.

Kryetari tha se teksti i harmonizuar i Projekt-Rezolutës ende nuk i është dorëzuar Kryesisë së Kuvendit për ta radhitur në rend dite të seancës plenare.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 22 janar 2009
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2008.
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për auditimin e brendshëm,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Zonat Ekonomike,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gazin natyror,
10. Rekomandimi i Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri dhe i Komisionit për Shërbime, Publike, Administratë Lokale dhe Media për Ligjin për gjendjen civile.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 22 janar 2009

Kuvendi miratoi, pa vërejtje, procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 22 janar 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetët **Riza Smaka** dhe **Heset Cakolli** i parashtruan pyetje ministrit të Shërbimeve Publike, Arsim Bajrami, lidhur me rregullimin e koeficientëve të pagave të funksionarëve publikë dhe nëpunësve civilë.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetëve Smaka dhe Cakolli

Deputetja **Njomza Emini** i parashtroi pyetje ministres së Energjisë dhe Minierave, Justina Pula lidhur me ngritjen e tarifës së faturës së energjisë elektrike.

Ministrja Justina Pula iu përgjigj pyetjes së deputetes Emini.

Deputeti **Heset Cakolli** parashtroi pyetje Ministrit të Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, Fatmir Limaj, lidhur me qendrat për kontrollimin teknik të automjeteve.

Ministri Fatmir Limaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Cakolli

Deputetja **Luljeta Shehu** i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, lidhur me mundësinë e arsimimit të grave të burgosura në burgun e Lipjanit...

Ministrja Nekibe Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetes Shehu

Deputeti **Naser Rugova** parashtroi pyetje për ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me pagat e punonjësve të institucioneve arsimore (sekretarëve dhe punonjësve ndihmës)..

Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Rugova.

Deputeti **Driton Tali** i parashtroi pyetje Kryeministrit Hashim Thaçi, zëvkryeministrit Kuçi apo ministrit të MASHT-it, Enver Hoxhaj, lidhur me përdorimin e dhunës në shkolla.

Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja **Rita Hajzeraj-Beqaj** parashtroi pyetje për ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me buxhetin shpenzues për shkolla.

Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Hajzeraj

Deputetja **Myfera Shinik** parashtroi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur me shfaqjen e sëmundjes hepatit A (verdhëza) në rajonin e Prizrenit.

Ministri Alush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Shinik.

Deputeti **Naim Rrustemi** i parashtroi pyetje zëvkryeministrit Hajredin Kuçi lidhur me dëmet e shkaktuara KEK-ut nga kompania ALFERON (Ferronikeli) gjatë vitit 2007-2008.

Ministrja Justina Pula iu përgjigj pyetjes së deputetit Rrustemi.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtroi pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë, Lutfi Zharku, lidhur përmirësimin e disproporcionit në mes të importit dhe eksportit të mallrave Kosovare.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

3. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2008

Kryesuesi ftoi Kryeministrin që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Raportin e punës së Qeverisë për vitin 2008.

Kryeministri **Hashim Thaçi** tha se Raporti vjetor i Qeverisë së Republikës së Kosovës paraqet punën dhe arritjet e saj dhe të popullit të Kosovës drejt realizimit të synimeve dhe të objektivave.

Qeveria e Kosovës arriti ta menaxhojë sfidën më të rëndësishme në historinë e popullit të Kosovës, duke përmbyllur suksesshëm ambiciet dhe përpjekjet njëshekullore për liri dhe pavarësi dhe duke përfaqësuar e respektuar vullnetin e popullit me shpalljen e Kosovës shtet i pavarur, sovran, demokratik, më 17 shkurt të vitit 2008.

Pavarësia, si e vetmja zgjidhje për popullin e Kosovës, në interes të paqes dhe të stabiliteti në vend dhe në rajon, është arritur me një bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare dhe me përkrahjen e saj të fuqishme.

Pavarësia e Kosovës deri më tani është njohur nga 54 shtete. Njohja është në proces aktiv dhe dinamik nga diplomacia kosovare me mbështetje të miqve ndërkombëtarë.

Njohja ka krijuar mundësitë e bashkëpunimit në nivel shtetëror dhe nevojën e funksionalizimit të institucioneve tona vendore.

Më 15 qershor 2008 ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila përfshin parimet bazë të Pakos së Presidentit Ahtisari. Të gjitha proceset zhvillimore politike dhe shoqërore janë të bazuara në parimet dhe dispozitat e Kushtetutës, duke garantuar sovranitetin territorial dhe barazinë para ligjit të të gjithë qytetarëve.

Simbolet shtetërore të Kosovës të cilat u nxorën, përfaqësojnë unitetin shtetëror dhe qytetar të vendit tonë.

Falë punës së suksesshme në Kosovë, u vlerësua progresi edhe në Raportin e Komisionit Evropian. Qeveria pranon përgjegjshëm edhe sfidat që dalin nga ky raport. Kosova me sukses të madh filloi përgatitjet dhe përfundoi punimet në Konferencën e Donatorëve. Ishte kjo mbështetje ndërkombëtare edhe financiare.

Si rezultat i punës së Qeverisë, BE-ja konfirmon hapin e parë të Kosovës drejt Bashkimit Evropian, i quajtur "studimi i fizibilitetit", i cili pritet të përfundojë në vjeshtë të vitit 2009. Buxheti i parë i Republikës së Kosovës për vitin 2009 është hartuar sipas standardeve më të larta duke pasur parasysh nevojat e gjithë qytetarëve të Kosovës. Ky buxhet është përmbi 15%

më i lartë në krahasim me vitin paraprak, në saje të planifikimit të drejtë, të kursimit dhe të uljes së shpenzimeve në Qeveri, në Presidencë dhe në Kuvend.

Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore dhe së shpejti pritet të bëhemi edhe pjesë e tyre.

Instalimi i qeverisjes së mirë, sundimi i ligjit, transparenca në punë, toleranca zero e Qeverisë në luftë kundër korrupsionit, ka bërë që Kosova sot të jetë e fundit në ranglistën e shteteve të rajonit për nivelin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Në sektorin e arsimit është bërë përmirësimi i vazhdueshëm dhe intensiv i infrastrukturës shkollore, i programeve mësimore bazë në të gjitha nivelet, përmirësimi i metodave të vlerësimit, fillimi i procesit të certifikimit për mësimdhënësit dhe zgjerimi i përdorimit të teknologjisë informative në shkolla.

Në sektorin e shëndetësisë për vitin 2009 është bërë rritja e buxhetit.

Në sektorin e bujqësisë është punuar në zgjerimin e sistemeve të ujitjes dhe nisjen e procesit të konsolidimit të tokave për ta shtuar produktivitetin dhe efikasitetin e sektorit të bujqësisë.

Në kuadër të detyrimeve kushtetuese, një vëmendje e veçantë i është kushtuar reformimit të pushtetit lokal, fushës së sigurisë, krijimit të institucioneve të reja dhe afirmimit të minoriteteve.

Zbatimi i procesit të decentralizimit vazhdon të jetë në agjendën e Qeverisë si një program ambicioz me përfitime të shumanshme për qytetarët e Kosovës.

Qeveria ka themeluar edhe Ministrinë e Punëve të Jashtme me qëllim të intensifikimit të marrëdhënieve diplomatike dhe fillimi vlerësohet i suksesshëm. Pra, vendosja e marrëdhënieve diplomatike me partnerët ndërkombëtarë kryesorë vazhdon të jetë një ndër aktivitetet kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Themelimi i Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe i mekanizmave të tjerë të sigurisë janë hapa vendimtarë në historinë moderne të Forcave të Armatosura për arritjen e standardeve bashkëkohore, ku gjithçka do të jetë sipas standardeve të NATO-s.

Qeveria vazhdon të jetë e përkushtuar në ndërmarrjen e veprimeve rreth themelimit të Gjykatës Kushtetuese, plotësisht funksionale, e cila do të jetë garant i rendit kushtetues.

Në kuadër të fushës së qeverisjes së mirë, Qeveria ka qenë e përkushtuar: në reformimin e administratës publike, menaxhimin e financave publike, luftimin e korrupsionit në vazhdimësi, përmirësimin e ekzekutimit të shpenzimeve kapitale.

Inicimi i shikimit funksional i shërbimit civil është një kërkesë pragmatike për të vendosur kritere dhe standarde, për krijimin e shërbimit civil, modern e të aftë për t'iu përgjigjur me efikasitet sfidave me të cilat përballlet sot Kosova.

Qeveria vëmendje të posaçme i kushton përmirësimit të performancës së institucioneve qeveritare që merren me mbledhjen e shpenzimit të parasë publike, përmirësimit, funksionimit dhe operimit të Administratës Tatimore dhe Doganore të Kosovës.

Mirëqenia sociale dhe shërbimet shëndetësore vazhdojnë të jenë brengat e Qeverisë së Kosovës dhe përkushtimet tona.

Pra, viti 2008 ishte vit i suksesit historik të institucioneve dhe të popullit të Kosovës. Zotohemi se viti 2009 do të jetë vit i thellimit të suksesit tonë të përbashkët.

Kryetari hapi debatin lidhur me Raportin e Qeverisë së Kosovës për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Raportin e punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2008 dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Nexhat Daci**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz**, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Slobodan Petroviq**, në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, **Slobodan Petkoviq** si dhe deputetët: **Gani Geci**, **Melihate Tërmmkolli**, **Gjylnaze Sylaj**, **Gani Bućinca**, **Ramë Manaj**, **Naim Maloku**, **Besa Gaxheri**, **Gani Koci**, **Zylfije Hundozi**, **Adem Salihaj**, **Nekibe Kelmendi**, **Hajredin Kuçi**, **Fatmir Limaj**, **Driton Tali**, **Fatmir Rexhepi**, **Numan Baliq**, **Edita Tahiri**, **Hajdin Abazi**, **Vezira Emrush**, **Bahri Hyseni**, **Hajredin Hyseni**, **Mihajlo Shqepanoviq**, **Branislav Grbiq**, **Bajram Kosumi**, **Riza Smaka**, **Safete Hadërgjonaj**, **Zef Morina**, **Shkumbin Demaliaj**, **Hydajet Hyseni**, **Esat Brajšhori**, **Myzejene Selmani**, **Mark Krasniqi**, **Enver Hoxhaj**, **Memli Krasniqi**, **Njomza Emini**, **Lulzim Zeneli**, **Sanije Aliaj**, **Xhevdet Neziraj**, **Naser Rugova**, **Qamile Morina**, **Kaqusha Jashari**, **Ramadan Avdiu**, **Suzanë Novobërdaliu**, **Berim Rasmosaj**, dhe **Heset Cakolli**; diskutimet i dorëzuan me shkrim këta deputetë: **Agim Veliu**, **Mimoza Ahmetaj**, **Myrvete Pantina**, **Rita Hajzeraj** dhe **Drita Kadriu**, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Kryetari e mbylli debatin për Raportin e punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2008 në orën 21:15 minuta.

E premte, 30 janar 2009
Vazhdim i seancës

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për auditimin e brendshëm

Kryesuesi Sabri Hamiti ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Ahmet Shala**, në emër të Qeverisë, tha se ndryshimet në ligj janë bazuar në nevojat e identifikuara nga ekspertët, nga auditori i brendshëm dhe nga auditimet për të përmirësuar funksionimin e auditimit të brendshëm nëpër institucionet e Republikës së Kosovës.

Veprimtaria e deritanishme e auditimit të brendshëm është mbështetur në Ligjin nr. 02/L72 për auditimin e brendshëm, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 16 nëntor 2006 dhe të shpallur nga PSSP-ja më 6 qershor 2007.

Kërkesa për ndryshimin përputhet me aspiratën tonë afatgjate për integrimin evropian dhe me dinamikën e Qeverisë sonë drejt ndryshimeve socio-ekonomike, e cila kërkon reflektim të nevojshëm e të menjëhershëm në kornizën ligjore sipas kërkesave të kohës.

Projektligji përcakton rregulla të sakta dhe efektive për të arritur një llogaridhënie më të mirë për shpenzime më të drejtë të parave publike, duke eliminuar vakuumin ligjor e institucional në mënyrë që qytetarët tanë të rritin respektin për organet e shtetit, duke përfshirë këtu edhe auditimin e brendshëm.

Ky Projektligj ka për qëllim që secili subjekt i sektorit publik të sigurojë që veprimtaritë, shënimet dhe sistemi i tij i menaxhimit të kontrollit t'i nënshtrohen në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse auditimit të brendshëm.

Në këtë Projektligj janë qartësuar definicioni, fushëveprimi, përkufizimi, roli i auditimit, autoriteti i strukturave të tilla, si dhe i komitetit të auditimit, njësitë e auditimit të brendshëm, afatet kohore të certifikimit të auditorëve të brendshëm, çështja e raportimit, mbrojtja e auditorëve, kontratat dhe pavarësia në punën e tyre dhe shumë çështje të tjera të cilat përmirësojnë punën në fushën e auditimit të brendshëm.

Me këtë projektligji në mënyrë të veçantë është rregulluar mbrojtja e auditorit, i cili në mënyrë më konkrete kërkon mbrojtjen e auditorit nga komiteti i auditimit dhe menaxhmenti i lartë i çdo organizate buxhetore. Është qartësuar edhe çështja e raportimeve të cilat me ligjin në fuqi shkaktonin konfuzion rreth raportimeve të auditorëve të brendshëm se kujt duhet raportuar.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Projektligjin për auditimin e brendshëm.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Rita Hajzeraj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Xhevdet Neziraj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Enis Kervan**, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Bojan Stojanoviq**, në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, **Sllavisha Petkoviq**, si dhe deputetët **Armend Zemaj**, **Myzejene Selmani**, **Riza Smaka** dhe **Gjylnaze Sylja**, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër-----0,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për auditimin e brendshëm.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat ekonomike

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Lutfi Zharku**, në emër të Qeverisë së Kosovës tha se krijimi i infrastrukturës fizike për përkrahjen e zhvillimit të sektorit privat dhe të ndërmarrje të vogla dhe të mesme, si shtyllë e zhvillimit ekonomik, është një ndër objektivat kryesorë të MTI-së.

Aktualisht, në vendin tonë ekzistojnë tre inkubatorë të biznesit, në Gjilan, Shtime dhe Deçan, kurse punët përfundimtare po kryhen edhe në dy parqet industriale në Drenas dhe në Mitrovicë.

Duke marrë parasysh nevojat në rritje për infrastrukturë fizike të ndërmarrjeve vendore dhe kërkesat në rritje nga ana e investitorëve të jashtëm, në njërën anë, si dhe kufizimet buxhetore, në anën tjetër, krijimi i bazës ligjore për menaxhimin e objekteve aktuale dhe hapja e rrugës për investime private në këtë fushë, është më se e domosdoshme.

Projektligji përcakton se nisma për krijimin e zonave ekonomike mund të vijë nga kuvendet komunale, komuniteti i biznesit, partneriteti publiko-privat, si dhe nga vetë Qeveria, gjegjësisht MTI.

Zonat ekonomike mund të krijohen në prona private dhe ose publike, kurse hapësira apo prona e aprovuar për destinim të këtillë, nuk mund të shpronësohet më pastaj.

Me qëllim të zbatimit të Ligjit, parashihet që në kuadër të Agjencionit për përkrahje të NMV-ve, të krijohet Divizioni për zonat ekonomike, i cili do të jetë përgjegjës për hartimin e politikave dhe të planeve për zhvillimin e zonave ekonomike, hartimin e rregulloreve dhe funksionimin e tyre, identifikimin e zonave potenciale dhe përgatitjen e procedurave për shpalljen e tyre, si dhe përcjelljen e zbatimit të këtij ligji.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Projektligjin për zonat ekonomike.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Tregti, Industri...dhe në emër të GP të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Myrvete Pantina**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Berim Ramosaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Myfera Sinik**, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović, emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, **Branislav Grbiq**, si dhe deputetët **Adem Hajdaraj** dhe **Riza Smaka**, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----48,
Kundër-----6,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për zonat ekonomike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti e Industri, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rezervat shtetërore

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Lutfi Zharku**, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se Projektligji për rezervat shtetërore nuk ka qenë i paraparë të jetë pjesë e strategjisë legjislative të vitit të kaluar. Por, rëndësia e tij për rrjedhat ekonomike të vendit, posaçërisht pas zhvillimeve të fundit në ekonominë botërore, na ka shtyrë që të përshejtojmë hartimin e këtij ligji.

Rezervat shtetërore të mallrave krijohen për të ndërhyrë në mënyrë operative për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, të emergjencës civile apo të luftës. Këto rezerva do të administrohen nga Departamenti i Rezervave Shtetërore të Mallrave, i cili do të themelohet në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë dhe që do të organizohet në nivel qendror dhe lokal.

Plani strategjik dhe programi vjetor me të cilin përcaktohet krijimi, ripërtëritja, përdorimi, shpërndarja dhe sigurimi i depove për vendosjen e tyre është paraparë që të aprovohen nga Qeveria.

Rezervat shtetërore të mallrave formohen si rezerva të përhershme dhe përbëhen prej prodhimeve themelore bujqësore, prodhimeve të caktuara joushqimore industriale, si dhe të mjeteve monetare.

Rezervat shtetërore krijohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, mallrat që vijnë si ndihmë humanitare, donacionet në mallra dhe ndihmat financiare, të hyrat vetanake të Departamentit të Rezervave Shtetërore, si dhe nga mallrat e konfiskuara.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Projektligjin për rezervat shtetërore.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Komisionit për Tregti, Industri...dhe në emër të GP të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Naser Osmani**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ethem Çeku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Bojan Stojanoviq**, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për rezervat shtetërore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti e Industri, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Lutfi Zharku**, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se MTI ka hartuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit me qëllim të rritjes së efikasitetit në këtë fushë.

Ndryshimet dhe plotësimet kryesore konsistojnë në rregullimin e fushës së shërbimeve publike: mallit me gabime, premtimit të shpërblimit, shitja me libër, shitja me aksion, kontratat në largësi, informimi dhe edukimi i konsumatorit, procedurat e ankesës së konsumatorit, si dhe formimin e Këshillit për mbrojtjen e konsumatorit.

Në fushën e shërbimeve publike, Projektligji përcakton qartë se shitja bëhet sipas çmimeve të përcaktuara nga rregullatori dhe se konsumatori paraprakisht duhet të njoftohet me të gjitha kushtet e shfrytëzimit të shërbimeve publike. Konsumatorit të rregullt nuk mund t'i ndërpritet ofrimi i shërbimit publik, nëse ai konteston ndonjë faturë me procedurë gjyqësore ose jashtëgjyqësore.

Projektligji obligon institucionet që japin autorizime për kryerjen e shërbimeve publike të kujdesen për cilësinë, furnizimin e rregullt dhe sasinë e atyre shërbimeve. Kontratat në largësi janë element i ri, që rregullohet me këtë ligj.

Projektligji rregullon në mënyrë të qartë Këshillin për mbrojtjen e konsumatorit, si organ këshillëdhënës, në përbërje të të cilit janë, përveç përfaqësuesve të MTI-së, edhe Shoqata për Mbrojtjen e Konsumatorëve, përfaqësuesit e biznesit dhe ekspertët nga fushat përkatëse.

Zbatimi i këtij ligji ndikon drejtpërdrejt në zvogëlimin e keqpërdorimeve të produkteve, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së njeriut, mbrojtjen e interesave të ligjshme të konsumatorit nëpërmjet plotësimit të kriterëve të caktuar të produkteve dhe shërbimeve.

Kryetari hapi debatin lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Komisionit për Tregti, Industri...dhe në emër të GP të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Kaqusha Jashari**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Fatmir Rexhepi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Kosara Nikoliq**, si dhe deputetët **Zef Morina**, **Ibrahim Makolli** dhe **Riza Smaka**, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër-----1,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti e Industri, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja **Nekibe Kelmendi**, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se nevoja për miratimin e këtij ligji është aktualisht më se e domosdoshme, sepse në Republikën e Kosovës nuk ekziston ndonjë mjet juridik i rregullimit të kësaj fushe, të marrëdhënieve të natyrës formale dhe joformale në rangun shtetëror.

Miratimi i këtij projektligji mundëson rregullimin e Protokollit të shtetit dhe ceremonialit zyrtar të Republikës së Kosovës për organizimin dhe realizimin e të gjitha veprimtarive kryesore protokollare të Presidentit të Republikës, të Kryetarit të Kuvendit, të Kryeministrit dhe të ministrit të Punëve të Jashtme, për të gjitha veprimtaritë brenda dhe jashtë vendit.

Qëllimi i këtij projektligji është që Ceremoniali i shtetit përfaqëson përmbledhjen institucionale të kriterëve që rregullojnë çdo aspekt të natyrës formale dhe joformale të marrëdhënieve zyrtare.

Zbatimi i këtyre kriterëve është kompetencë e Protokollit të shtetit.

Projektligji është harmonizuar në tërësi me Acquis communautaire dhe i propozoj Kuvendit që ta miratojë.

Kryetari hapi debatin lidhur me Projektligjin për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Jashtme dhe në emër të GP të LDK-së, **Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramadan Avdiu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Enis Kervan**, dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Sillobodan Petroviq**, si dhe deputetët **Bahri Hyseni**, **Emrush Xhemajli**, **Edita Tahiri**, **Hydajet Hyseni**, **Riza Smaka**, **Arsim Rexhepi**, dhe **Gani Buçinca**, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----41,
Kundër-----14,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Jashtme, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gazin natyror

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Lutfi Zharku**, në emër të Qeverisë së Kosovës tha se Projektligji përcakton parimet themelore mbi organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit natyror, qasjen ndaj tregut, kriteret dhe procedurat e vlefshme për dhënien e autorizimeve për bartjen, shpërndarjen, furnizimin, deponimin e gazit natyror dhe operimin e sistemeve.

Qëllimet themelore të këtij Projektligji janë: krijimi i një baze të mirëfilltë dhe të qëndrueshme ligjore në sektorin e gazit natyror për bartjen, shpërndarjen, furnizimin dhe depozitimin e gazit natyror, si dhe nxitjen e investimeve private duke ofruar bazë të mjaftueshme për investitorët potencial në sektorin e Energjisë dhe të Minierave, respektivisht gazit natyror.

Miratimi i këtij projektligji është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e energjisë, si dhe është i një rëndësie të veçantë, sepse do t’i hapte rrugë zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik të vendit nëpërmjet përgatitjes së terrenit të përshtatshëm për ngritjen e kapaciteteve të reja të cilat do të ndikojnë në uljen e shpenzimeve energjetike në prodhim e produkte, mbrojtjen më të mirë të mjedisit, si dhe në shfrytëzimin më racional të burimeve energjetike, duke rritur edhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike në Kosovë si rezultat i përdorimit të teknologjive moderne të kursimit dhe të furnizimit të energjisë.

Kryetari hapi debatin lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Komisionit për Tregti, Industri...dhenë emër të GP të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Fatmir Rexhepi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ethem Çeku** dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Mufera Sinik**, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Në mungesë të kuorumit, Kryetari deklaroi seancën të mbyllur, për t’i vazhduar punimet të hënën.

E hënë, 2 shkurt 2009

Vazhdim i seancës

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 69 deputetë.

Ai i njoftoi deputetët se seanca e së premtes i ka ndërprerë punimet në mungesë të kuorumit.

Kryetari procedoi me votimin e Projektligjit për gazin natyror. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----21,
Abstenime-----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për gazin natyror.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti e Industri, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Rekomandimi i Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri dhe i Komisionit për Shërbime, Publike, Administratë Lokale dhe Media për Ligjin për gjendjen civile

Kryetari i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, në cilësi të komisioneve përgjegjëse raportuese, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 30 korrik 2008, dhe të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit, të datës 29 shtator 2008, kanë rishqyrtuar Ligjin për gjendjen civile dhe Kuvendit i kanë parashtruar raportin me rekomandime.

Kryetari hodhi në votim Rekomandimet e Komisionit Funksional. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----53,
Kundër-----3,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Ligji për gjendjen civile i kthehet Qeverisë së Kosovës për ri-hartim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**